

**INTERIM ADMINISTRATION OF KOSOVA
ADMINISTRATA E PËRKOHSHME E KOSOVËS
PRIVREMENA ADMINISTRACIJA KOSOVA**




Prokuroria Publike e Qarkut
Prishtinë
PP –KT 546-1/07
CIR 2007/632/PRS/DW
14 Nëntor 2007

**GJYKATËS SË QARKUT TË
PRISHTINËS**

1. Në bazë të nenit 304 dhe 305 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (KPPPK), Deborah Wilkinson, Prokurore Publike Ndërkombëtare, duke vepruar në cilësinë e Prokurores Publike të Qarkut, Qarku i Prishtinës, ngritë si në vijim

AKTAKUZË

KUNDËR:

| | |
|--|---|
| Emri dhe mbiemri: | Gani Gashi |
| Pseudonimi: | |
| Emri dhe mbiemri i babës: |  Gashi |
| Emri i nënës: |  |
| Mbiemri i vajzërisë i nënës: |  |
| Kombi: | Shqiptar i Kosovës |
| Nënshtetësia: | |
| Profesioni: | Bujk |
| Vendbanimi: | Pjesa e parë e fshatit Komoran Komuna e Glllogocit |
| Vendi i lindjes: | Fshati Komoran |
| Data e lindjes: | 19 tetor 1949 |
| Gjendja familjare: | I martuar, 4 fëmijë |
| Niveli i shkollimit: | Klasa e 8-të |
| Din të shkruaj dhe lexojë: | Po |
| Të ardhurat personale: | 150 euro në muaj |
| Gjendja financiare: | I varfër |
| Numri Personal i Identifikimit: | 1002141562 |
| Procedurat tjera penale në zhvillim e sipër: | Nuk ka të dhëna penale |
| Gjendja e ndaljes: | Në paraburgim prej 16 gushtit 2007 |

PËRSHKRIMI DHE KUALIFIKIMI LIGJOR I VEPRAVE PENALE
(në bazë të nenit 305, paragrafit 1, nën-paragrafit 3 dhe nenit
305, paragrafit 1, nën-paragrafit 4 të KPPPK)

Pika 1

2. Se më 12 korrik 1998, Gani Gashi, duke i shkelur rregullat e ligjit ndërkombëtar në fuqi në kohën e luftës, të konfliktit të armatosur, ose okupacionit, domethënë të neneve 3 dhe 147 të Konventës së Gjenevës lidhur me Mbrojtjen e Civilëve në Kohën e Luftës (pas kësaj Konventa e Gjenevës IV) dhe duke shkelur neni 4 të Protokollit II të Konventave të Gjenevës, ka kryer:

- A. vrasjen me dashje të I ■■■ O ■■■, një personi civil, duke shtënë atë në shpinë me një armë zjarri përshkrimi i së cilës është i panjohur, në rrugën në mes të fshatit Komoran dhe fshatit Kishnarekë në Komunën e Glllogocit, Kosovë, dhe si rezultat i kësaj gjuajtjeje I ■■■ O ■■■ ka vdekur;
- B. tentim të vrasjes me dashje të Sh ■■■ O ■■■, një personi civil, duke shtënë në atë në kokë me një armë zjarri përshkrimi i së cilës është i panjohur, derisa Sh ■■■ O ■■■ ishte i ulur në një automjet Fiat në rrugën në mes të fshatit Komoran dhe Kishnarekë në Komunën e Glllogocit, Kosovë;
- C. shkelja e integritetit të trupit dhe të shëndetit të H ■■■ O ■■■ dhe S ■■■ O ■■■, personave civil, duke shtënë në ta me një armë zjarri përshkrimi i së cilës është i panjohur, derisa H ■■■ O ■■■ dhe S ■■■ O ■■■ kanë qenë të ulur në një automjet Fiat në rrugën në mes të fshatit Komoran dhe fshatit Kishnarekë në Komunën e Glllogocit, Kosovë.

3. Me këto veprime i pandehuri ka kryer veprën penale të *Krimeve të luftës kundër popullatës civile* (vrasja dhe tentim vrasja e civilëve dhe shkelja e integritetit të trupit dhe shëndetit) duke shkelur nenin 142 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë të dënueshme me burgim jo më pak se pesë (5) vjet dhe jo më tepër se katër dhjetë (40) vjet.

SHPJEGIMI I BAZAVE PËR NGRITJEN E AKTAKUZËS
(në bazë të nenit 305, paragrafit 1, nën-paragrafit 5 të KPPPK)

4. Në korrik 1998 ka ekzistuar një gjendje e konfliktit të brendshëm të armatosur në mes të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (“UÇK”) ose të njohur si Kosovo Liberation Army (KLA), dhe Republikës Federative të Serbisë dhe Republikës Federative të Jugosllavisë, duke përfshirë Armatën Jugosllave (VJ), forcat e Ministrisë së Brendshme të Republikës Federative të Jugosllavisë (RFJ), forcat Ministrisë së Brendshme të Republikës së Serbisë dhe ushtarët paramilitarë të Serbisë në territorin e Kosovës. Që të dy forca të armatosura kanë qenë nën komandën përgjegjëse dhe kanë zhvilluar kontrollin mbi pjesën e territorit të Kosovës, duke i mundësuar ata që të kryejnë operacionet ushtarake të pandërprera dhe të përbashkëta.

5. I pandehuri në kohën e veprës penale ka qenë duke vepruar në emër të forcave të armatosura të UÇK-ës dhe ka qenë një palë e konfliktit, për këtë prej tij kërkohet që të

nënshtrrohej rregullave ndërkombëtare lidhur me mbrojtjen e popullatës civile gjatë konflikteve të armatosura ndërkombëtare dhe të brendshme.

6. Viktimat e krimeve të luftës në të cilat referohet kjo aktakuzë kanë qenë anëtarët e popullatës civile dhe nuk kanë marr pjesë në asnjë armiqësi të drejtpërdrejtë. Kështu, ata kanë qenë personat e mbrojtur sikur që definohet me Konventën e Gjenevës IV dhe me Protokollin II të Konventave të Gjenevës.

7. Ekziston një lidhje në mes të veprave të pandehurit që përmbajnë krimet e luftës, sikur që ngarkohet në këtë Aktakuzë, dhe të konfliktit të brendshëm të armatosur që ishte duke u zhvilluar në Kosovë në korrik të viti 1998. Ekzistimi i konfliktit të armatosur ka luajtur një rol qenësor në mundësinë e të akuzuarit që të kryej veprat, dhe veprimet e të akuzuarit kanë qenë drejtpërdrejt të lidhura me konfliktin e armatosur.

8. Më 8 korrik 1998, në mbrëmje, tetë anëtarë të familjes O [REDACTED] kanë qenë duke udhëtuar në një automobil Fiat Croma nga fshati Komoran për në fshatin Kishnarekë (të dy fshatra gjinden brenda Komunës së Glllogocit). Anëtarët e familjes O [REDACTED] në atë kohë në Fiat kanë qenë: A [REDACTED] O [REDACTED] (madhor), vozitës; I [REDACTED] O [REDACTED] (madhor) dhe Sh [REDACTED] O [REDACTED] (fëmija) në ulësen e përparme të udhëtarit; dhe H [REDACTED] O [REDACTED] (madhore), Sh [REDACTED] O [REDACTED] (fëmija), F [REDACTED] O [REDACTED] (madhor), B [REDACTED] O [REDACTED] (madhor), dhe S [REDACTED] O [REDACTED] (madhor) në ulëset e prapme. Sh [REDACTED] O [REDACTED] ka qenë i ulur në prehër të I [REDACTED] O [REDACTED]

9. Të gjithë 8 persona në Fiat kanë qenë civilë, dhe asnjë prej tyre nuk ka marr pjesë ose nuk ka qenë duke marr pjesë në çfarëdo armiqësi nga cilado anë e konfliktit të armatosur në mes të UÇK-ës dhe forcave të armatosura të RFJ dhe të Republikës së Serbisë. Asnjë anëtar i familjes O [REDACTED] kurrë nuk ka punuar për policinë e Republikës së Serbisë ose për Shërbimin e Sigurimit Shtetëror të RFJ. Arsyeja pse familja O [REDACTED] ka qenë duke udhëtuar në mbrëmje të 12 korrikut 1998 ishte sepse forcat serbe kanë qenë duke zhvilluar një operacion ushtarak në zonën e fshatit të Komoranit, ku ata kanë jetuar, dhe fshati Kishnarekë në atë kohë ka qenë një vend më i sigurt për të qenë.

10. Një patrullë e UÇK-ës ka ndalur Fiatin në rrugë për Kishnarekë. Kjo patrullë përbëhej prej dy meshkujve, Gani Gashit dhe Xh [REDACTED] N [REDACTED], të cilët kanë qenë të veshur në uniforma me lara dhe kanë qenë të armatosur me pushkë AK-47. Pas një bisede të shkurtër me familjen O [REDACTED], dhe pasi që kanë kontrolluar dokumentet e tyre, Xh [REDACTED] N [REDACTED] u largu nga vendi i ngjarjes për të thirr një oficer të lartë të UÇK-ës, M [REDACTED] V [REDACTED]. Në atë kohë Gani Gashi ka shkrepur zjarr me pushkën e tij, duke shtënë së paku një herë në anëtarët e familjes O [REDACTED] të ulur në automobil.

11. Si rezultat i të shtënave katër anëtarë të familjes O [REDACTED] kanë pësuar lëndime. I [REDACTED] O [REDACTED] ka vdekur shkurt pas incidentit si rezultat i plagëve nga të shtënat e armës. Sh [REDACTED] O [REDACTED] ka marr një plagë në kokë nga plumbi, por plumbi nuk ka shkaktuar kurrfarë dëmtimi të dukshëm të trurit të tij. Sh [REDACTED] O [REDACTED] ishte dërguar nga familja e tij në spitalin e Prishtinës, ku mjekët kanë nxjerrë plumbin prej kokës së tij. S [REDACTED] O [REDACTED] ka marr një plagë nga plumbi në shpatullën e djathtë. H [REDACTED] O [REDACTED] ka marr një plagë në buzën e sipërme, dhe ajo ka pësuar një humbje të rëndë të dëgjimit të veshit të majtë.

12. A ■■■ O ■■■, djali i të ndjerit I ■■■ O ■■■, për herë të parë ka raportuar këtë incident Njësisë së Hetimit të Krimeve të Luftës të Policisë së UNMIK-ut në nëntor 2006. A ■■■ O ■■■ i tha policisë se ai nuk ka raportuar më herët vrasjen e babës së tij sepse ai u frikësua se vëllai I Gani Gashit, Xh ■■■ G ■■■ alias “Plaku”¹ apo “Komandant P ■■■”, do të hakmerrej kundër familjes së tij poqëse ai do ta njoftonte policinë. Xh ■■■ G ■■■ ishte një komandant i lartë i UÇK-së gjatë viteve 1998-1999 të konfliktit në Kosovë, dhe mëpastaj shërbeu si oficer në *Trupat e Mbrojtjes së Kosovës*(TMK). Xh ■■■ G ■■■ vdiq me 21 Mars 2005.

Përmbledhja e provave të mbledhura gjatë hetimit

Deklarata e të Pandehurit dhënë Policisë së UNMIK-ut me 17 Gusht 2007

13. Kur ishte intervistuar nga policia me 16 Gusht 2007, Gani Gashi pranoi të ketë shtënë dhe vrasë I ■■■ O ■■■. Sidoqoftë, ai dha shpjegime konfliktuoze se si ndodhi incidenti. Ai deklaroi se UÇK-së i ishte bashkangjitur pesëmbëdhjetë ditë përpara 12 Korrikut 1998, dhe se me 12 Korrik 2007 ai ishte duke shërbyer si ushtar i UÇK-së. Ai ishte caktuar në një pikë kontrolli; detyra ishte që të mbrohet popullata e Kosovës. Me 12 Korrik 1998 ai e filloi ndërimin e tij rreth orës 22.00h së bashku me Xh ■■■ N ■■■. Në përafërsisht 22.30h një veturë kaloi përmes pikës së kontrollit të tij me drita të fikura. Ajo u ndal nja 10 metra më larg. Tre veta dolën nga vetura. A ■■■ O ■■■ shtiu në të minimum tri(3) herë me një lloj revoleje. Ai ktheu zjarrin me një të shtënë të vetme. Pas kësaj dy nga vëllezërit e A ■■■ (ata të cilët tani jetojnë në Itali) iu afruan të pandehurit dhe i rrëmbyen pushkën e tij. Ai e përsëriti se kurrë nuk kishte pasur mosmarrëveshje me familjen O ■■■ përpara incidentit.

14. Gjatë intervistës së njëjtë ai e ndryshoi deklaratën e tij, duke thënë se ishte ai, Gashi i cili shtiu i pari, dhe se ai shtiu vetëm në ajër me qëllim që ta ndal veturën. Sipas verzionit të dytë të ngjarjeve, askush tjetër përveq tij nuk hapi zjarr. Kur u konfrontua me një pjesë të deklaratës së A ■■■ O ■■■, i pandehuri mohoi që ndonjëherë ti jetë afruar veturës, të ketë folur me anëtarët e familjes O ■■■, të ketë kërcënuar verbalisht familjen O ■■■, apo të ketë shtënë në veturë nga një distancë e afërt.

15. I pandehuri deklaroi se pas incidentit ai ende kishte njëzet e nëntë plumba në armën e tij për t’i kthyer prapa njësitit të tij, nga tridhjetë plumba që atij i ishin dhënë para fillimit të ndërrimit, dhe së lëshimi dhe kthimi i municionit regjistruar në një libër nga dikush në njësit. Ai poashtu tha se menjëherë pas incidentit ai ishte përjashtuar nga UÇK-ja. M ■■■ V ■■■ ishte komandanti i njësitit të tij.

Deklarata e të pandehurit dhënë Gjykatësit Paraprak gjatë ndëgjimit mbi paraburgimin me datë 17 Gusht 2007.

16. Gjersa po intervistohet prej Gjykatësit paraprak gjatë ndëgjimit mbi paraburgimin me 17 Gusht 2007, i pandehuri përsëri pranoi të ketë shtjerë dhe vrasë viktimën, por theksoi se ajo ishte aksidentalisht. I Pandehuri i tha Gjykatësit paraprak së me 12 Korrik 1998 ai ishte duke bërë sigurinë e nja tridhjetë ushtarëve të UÇK-së dhe civilëve që ishin duke hapur llogore në afërsi. Ai tha se vetura e familjes O ■■■ e

¹ “Plak”- Fjalë që në gjuhën shqipe do të thotë njeri i vjetër(spjegimi si në original)

kaloi atë dhe u ndal për afërsisht një dhjetë metra larg nga ai dhe Xh [REDACTED] N [REDACTED]. Sipas të pandehurit, ai i tha Xh [REDACTED] N [REDACTED] të shkoj dhe të kontrolloj veturën, dhe kur N [REDACTED] iu afrua veturës vozitësi e rriti shpejtësinë e veturës (shtypi pedalën e gasit), dhe ai (i pandehuri) shkrepiti të shtëna sepse mendoi se personat në veturë ishin armiqë. Menjëherë pasi që ai e ndëgjoi britmën, O [REDACTED] dolën nga vetura, dhe A [REDACTED] O [REDACTED] shtiu dy herë me pistoletë.

Deklarata e A [REDACTED] O [REDACTED] dhënë Policisë së UNMIK-ut me 13 Shkurt 2007

17. Pala e dëmtuar A [REDACTED] O [REDACTED] i tha policisë se në Korrik të 1998 ai dhe familja e tij ishin detyruar, së bashku me fshatarët tjerë, të lëshojnë shtëpitë e tyre në Komoran/Komorane për shkak të luftimeve me forcat Serbe. Sipas Agimit, familja shkoi për të qëndruar në fshatin e Kishnarekës/Kišna Reka, dhe çdo dy-tri ditë rregullisht ata do ktheheshin në shtëpinë e tyre në Komoran/Komorane për të marrë ushqim. Me 12 Korrik 1998, A [REDACTED] i kujtohet se kur ai dhe familja e tij ishin në shtëpinë e tyre në Komoran/Komorane, udhëheqësi i fshatit, I [REDACTED] B [REDACTED], ishte kthyer atypari dhe i kishte thënë atij se dy jerëz nga familja e tyre duheshin të gërmonin llogor për UÇK-në. I [REDACTED] O [REDACTED] u pajtua që të dërgoj dy djemtë e tij të bëjnë atë pas që të ketë përenduar dielli. er bërtiti: “Lermëni ti vrasë të gjithë, nuk dua që asnjë nga ata të jetojë”*.

18. A [REDACTED] tutje u ndërlidh se familja e tij, përfshirë babanë e tij I [REDACTED], nënën e tij H [REDACTED], vëllezërit e tij S [REDACTED] dhe F [REDACTED], djalin e tij Sh [REDACTED], dhe nipin e tij Sh [REDACTED], e lëshuan shtëpinë e tyre në Komoran/Komorane me automjetin Fiat Croma pas rënies së territ. Për afërsisht 200-300 metra larg nga shtëpia e tyre, ai tha se ata ishin ndalur nga dy ushtarë të UÇK-së, të identifikuar nga A [REDACTED] si Gani Gashi dhe Xh [REDACTED] N [REDACTED], të cilët u hodhën përpara veturës së tyre. Gani Gashi qëndroi nga ana e dritarës së vozitësit me një armë, të përshkruar nga A [REDACTED] si AK-47 kinez të drejtuar kah ai. A [REDACTED] e uli xhamin e dritarës së tij dhe e përshëndeti të pandehurin, i cili kërkoi të dinte se kush ishte në veturë. A [REDACTED] i tha atij së bashkëudhëtarët në veturë ishin nëna e tij, babai, vëllezërit, dhe dy fëmijët, shpjegoi se kishin marrur ushqim nga shtëpia e tyre, dhe se duheshin të shkonin sepse dy nga vëllezërit duheshin të gërmonin llogore. G [REDACTED] i tha A [REDACTED] t se nuk mund të shkonin.

19. Sipas A [REDACTED], G [REDACTED] mëpastaj i tha Xh [REDACTED] N [REDACTED] të thërras M [REDACTED] V [REDACTED], komandantin e njësitit. N [REDACTED] u largua që të thërras komandantin. Gashi pastaj tha “Është kohë e gjatë që unë jam duke të kërkuar ty”, doli pas automobilin të O [REDACTED], dhe filloi të shtiej në ta. Babanë e tij e kishte qëlluar dy here, njëherë prapa koke dhe njëherë në fytyrë, vëllau i tij S [REDACTED] ishte qëlluar në mes të shpatullave, nëna e tij ishte qëlluar në buzë, dhe nipi i tij Sh [REDACTED] ishte qëlluar prapa kokës. A [REDACTED] rrëfen se Xh [REDACTED] N [REDACTED] e ndali Gashin në të shtënit duke e kapur atë gjersa Gashi po thoshte “Më ler ti vras të gjithë, nuk dua që ndonjë nga ata të jetojë.”

20. Pas incidentit M [REDACTED] V [REDACTED] i shoqëroi ata në veturën e tyre me qëllim që të ndihmoj të gjendet një mjek. H [REDACTED] O [REDACTED] dhe Sh [REDACTED] O [REDACTED] mbetën aty. Doktorin I [REDACTED] B [REDACTED] i ofroi ndihmën fillestare Sh [REDACTED] dhe S [REDACTED], dhe rekomandoi që ata ta dërgojnë Sh [REDACTED] në Spitalin e UÇK-së në fshatin Likoshan. Ata bënë ashtu,

**Shënim i përkthyesit: teksti si në origjinal*

por mjekët nuk ishin në gjendje ta nxjerrin plumbin. Prandaj disa ditë më vonë A [redacted] e dërgoi Sh [redacted] në spitalin e Prishtinës/Priština ku Dr.T [redacted] Gj [redacted] e operoi atë dhe e nxorri plumbin nga kafka e tij.

Deklarata e H [redacted] O [redacted] dhënë Policisë së UNMIK-ut me 20 Mars 2007

21. Përshkrimi H [redacted] O [redacted] i ngjarjeve i 12 Korrikut 2007 ishte në përputhje me atë të dhënë nga A [redacted] O [redacted], B [redacted] O [redacted], dhe F [redacted] O [redacted]. Ajo poashtu deklaroi se asaj i kujtohet i pandehuri të ketë thënë, kur ai po qëndronte pranë derës së vozitësit të veturës, “Për këtë kam shpresuar, që të ju gjej juve të gjithëve bashkë”. Ajo poashtu kujton që ai shkoi prapa veturës, mundi ta dëgjonte zërin e armës duke u mbushur. Ajo i tha policisë se e dinte se ai do ti vriste ata, por nuk desh ti frikësonte nipat e saj prandaj nuk tha asgjë, por vetëm shikoi përreth dhe e pa të pandehurin parapa veturës.

22. H [redacted] raportoi shtoi se përveq marrjes së lëndimit nga të shtënit në buzë, ajo poashtu humbi 90% të aftësisë së saj të ndëgjimit në veshin e majtë si pasojë e të shtënit.

Deklarata e F [redacted] O [redacted] dhënë Policisë së UNMIK-ut me 10 Gusht 2007

23. Përshkrimi i F [redacted] O [redacted] i ngjarjes i 12 Korrikut 2007 ishte në përputhshmëri me atë të dhënë nga A [redacted] O [redacted], H [redacted] O [redacted], dhe B [redacted] O [redacted]. F [redacted] specifikoi se i pandehuri ishte 5-6 metra prapa veturës kur filloi të shtiej, dhe ai tha se ai kishte dëgjuar së paku 2 të shtëna. Sipas F [redacted], i pandehuri qëndronte prapa veturës në anën e majtë, duke spjeguar se përse plumbat dëpërtuan veturën nga ana e majtë prapa në drejtim të anës së përparme të djathtë.

Deklarata e B [redacted] O [redacted] dhënë Policisë së UNMIK-ut me 10 Gusht 2007

24. Përshkrimi i B [redacted] O [redacted] i ngjarjeve i 12 Korrikut 2007 ishte në përputhshmëri me atë të dhënë nga A [redacted] O [redacted], H [redacted] O [redacted], dhe F [redacted] O [redacted].

Deklarata e Xh [redacted] N [redacted] dhënë Policisë së UNMIK-ut me 22 Gusht 2007

25. Xh [redacted] N [redacted] i tha policisë se ai ishte duke shërbyer në UÇK në Korrik të 1998, dhe se me 12 Korrik 1998 ai ishte në detyrë me kushërinin e Gani Gashit, J [redacted] G [redacted]. Në përafërsisht 21.00h Gani Gashi e morri detyrën nga J [redacted]. Detyra e tyre ishte të ruajnë punëtorët që ishin duke hapur llogore për UÇK-në në atë zonë. Aty ishin rreth tridhjetë njerëz që po gërmonin llogore. Komandanti M [redacted] V [redacted] i tregoi N [redacted] dhe të pandehurit vendin ku ata duhej të ngrinin pikën e kontrollit.

26. Pas ca kohësh në pozicion ata e ndëgjuan një automjet duke u afruar. Ata vendosen që ta ndalojnë dhe ta kontrollojnë atë. Kur vetura u afrua, Ganiu doli në rrugë dhe dha shenjë që vetura të ndalet. Ajo u ndal menjëherë para tyre. Ajo nuk lëvizti më. Ata të dytë ishin tek dera e vozitësit, A [redacted] O [redacted], e uli xhamin e dritarës dhe pyeti se çfarë po ndodhte. Ganiu i tha dëshmitarit që të shkonte dhe ta thërras komandant M [redacted] V [redacted] dhe ai shkoi që ta thërriste atë. M [redacted] duhej të ishte në vendin ku llogoret ishin duke u përgatitur.

27. Ai i bëri vetëm nja 20-30 hapa kur e ndëgjoi një të shtënë të vetme. Ai bërtiti duke e pyetur Ganiu pse shtiu por nuk morri përgjegje. Ai u kthye prapa dhe e pa veturën e njejtë duke ardhur në drejtim të tij. Ajo iu afrua atij dhe u ndal. A [redacted] e hapi derën duke bërtitur “Gani na vrau!”. Dëshmitari përsëri vazhdoi të ec për ta thirrur M [redacted] V [redacted]. Pastaj ai ndëgjoi një të shtënë tjetër, e cila u duk si nga një revolver. Kur ai mbërriti në vendin me llogore M [redacted] tanimë kishte shkuar. Kur dëshmitari u kthye tek vetura, M [redacted] po e shtyente A [redacted] prapa kah vetura. M [redacted] poashtu hyri në veturë dhe ata shkuan nga aty.

28. Rreth një orë pas të shtënave, tek ai shkuan Gani Gashi dhe M [redacted] V [redacted] në lagjen Buzhala. V [redacted] i tha N [redacted] se ai (N [redacted]) duhej të thoshte se automjeti nuk ishte ndalur, të cilën dëshmitari e refuzoi. Dy ditë më vonë ai u intervistua për këto të shtëna nga komandanti i njësisë së UÇK-së, F [redacted] Sh [redacted]. Në atë deklaratë ai tha të vërtetën që është përshkruar këtu. Pas kësaj interviste me F [redacted] Sh [redacted], N [redacted] e takoi M [redacted] V [redacted], i cili e pyeti se cfarë i kishte thënë Sh [redacted]. Kur N [redacted] i kishte treguar atij, V [redacted] i ishte përgjigjur, “Ti nuk duhej ta kishe thënë atë.”

29. Më 18 Gusht 2007, pas orës 21:00, A [redacted] G [redacted] dhe Z [redacted] G [redacted] shkuan në shtëpinë e tij. Ata e informuan se Gani Gashi ishte arrestuar nga policia e UNMIK-ut. A [redacted] i tha atij se, nëse një ushtar i UÇK-së akuzohet për vrasje, kjo do të “ndynte” emrin e UÇK-së. N [redacted] tha se ai ishte përgjigjur që I [redacted] O [redacted] nuk e kishte vrarë UÇK, por një ushtar i vetëm, dhe se ai do të tregonte vetëm të vërtetën. Para se të largohej, A [redacted] i tha N [redacted] të mos i tregonte njeriu se ai kishte qenë në shtëpinë e tij.

30. Rreth orës 20:00 të datës 20 Gusht 2007, J [redacted] N [redacted] dhe djali i tij A [redacted] shkuan në shtëpinë e tij. Ata thanë se A [redacted] kishte dëshmuar në polici se Ganiu ishte përpjekur t’i vriste të gjithë ata dhe se dëshmitari e kishte ndaluar që ta bënte këtë, së cilës dëshmitari iu përgjigj se nuk kishte ndodhur ashtu. J [redacted] i kërkoi atij të vërtetonte deklaratën e A [redacted], por dëshmitari nuk pranoi.

31. N [redacted] i tha policisë se ushtarët e UÇK-së në njësinë e tij mbanin armët e tyre personale (pushkë) dhe se nuk ishin të detyruar t’i kthenin ato tek njësia pas ndërresave të tyre.

Deklarata e I [redacted] B [redacted] dhënë Policisë së UNMIK-ut më 6 Qershor 2007

32. Dr. B [redacted] ishte profesionisti i parë i shëndetit që i pa O [redacted] pas incidentit. Ai deklaroi se në fillim viktimat kishin shkuar në shtëpinë e asistentit të tij, I [redacted] G [redacted], i cili i dërgoi ata tek ai, sepse lëndimet ishin tepër të rënda për t’u trajtuar nga Z. G [redacted]. Sipas Dr. B [redacted], I [redacted] O [redacted] u soll në shtëpinë e tij (Dr. B [redacted]). Trupi ishte ende i ngrohtë, por pa shenja jete. Në pjesën e prapme të zverkut kishte gjakderdhje. Me këmbënguljen e familjes O [redacted] ai u përpoq t’i jepte I [redacted] kadrio stimulim me dorë, por kjo nuk dha rezultat.

33. Sipas Dr. B [redacted], ai vërejti një plagë në fytin e I [redacted] O [redacted], dhe ai (Dr. B [redacted]) mendoi se e shtëna kishte ardhur nga prapa. Ai besoi se I [redacted] O [redacted] kishte vdekur në cast nga e shtëna e armës së zjarrit. Dr. B [redacted] raportoi se ai nuk kishte lëshuar certifikatë vdekjeje për I [redacted] O [redacted] dhe se ai nuk kishte të dhëna të vetat për përfshirjen e tij në trajtimin e anëtarëve të familjes O [redacted] më 12 Korrik 1998.

Deklarata e I ■ G ■ dhënë Policisë së UNMIK-ut më 6 Nëntor 2007

34. I ■ G ■, i cili e përshkroi profesionin e tij si “asistent i patologut që kryen autopsi”, i tha policisë se I ■ O ■ ishte tashmë i vdekur kur ai e kishte parë atë në ditën e ngjarjes. Z. G ■ deklaroi se ai as nuk i kishte këqyrur plagët e I ■ O ■, sepse ai kishte qenë tepër i zënë duke u kujdesur për anëtarët e tjerë të plagosur të familjes.

Deklarata e H ■ H ■ dhënë Policisë së UNMIK-ut më 6 Korrik 2007

35. Dëshmitari, bashkë me R ■ Th ■ (daja i Shpëtimit dhe vëllai i nënës së Sh ■), e kishte vizituar familjen e viktimës ditën tjetër pas ndodhjes së vrasjes. Me atë rast, A ■ i tha atij: “Nuk kisha menduar kurrë se G ■ B ■ do të vriste babain tim.” Ai kishte parë trupin e I ■. Në fytin e tij ishte një vrimë e madhe. Një imam² i zonës kishte larë trupin e viktimës. Kur H ■ kishte parë kerrin Fiat Croma të viktimës pas incidentit, dritarja e prapme ishte krejtësisht e thyer por ai nuk kishte parë ndonjë vrimë plumbi në trupin metalik të kerrit.

36. Dy deri në tre vjet më parë, sipas Z. H ■, Gani Gashi bashkë me vëllezërit e tij Xh ■ “P ■” G ■ dhe R ■ G ■ i ishin afruar atij dhe babait të tij H ■ H ■. Ata i kishin kërkuar ndihmë për t’u pajtuar me familjen O ■ për shkak të asaj vrasjeje. H ■ H ■ i kishte thënë se ishte tepër vonë, sepse kishin kaluar shtatë vite, por premtoi të organizonte një takim midis familjeve në prani të Imamit. Megjithatë, asnjë prej G ■ nuk u paraqit më. Z. H ■ deklaroi se Gani Gashi, Xh ■ G ■ dhe R ■ G ■ nuk e kishin kërcënuar atë apo familjen O ■.

Deklarata e F ■ Sh ■ dhënë Policisë së UNMIK-ut më 12 Shtator 2007

37. F ■ Sh ■ ishte komandant i Njësisë “P ■” të UÇK-së që vepronte në atë zonë ku ndodhi krimi. Sh ■ i tregoi policisë se ai nuk kishte zenë prezent kur ishte qëlluar mbi familjen O ■, por se ishte informuar për incidentit nga lajmëtari. Sh ■ pretendoi se ai kishte patur një sërë bisedash me të pandehurin pas të shtënave, dhe se i pandehuri i kishte thënë atij se automjeti i O ■ nuk ishte ndalur në pikën e kontrollit dhe se ai kishte hapur zjarr sepse kishte menduar se ishte automjeti i policisë serbe. Sipas Sh ■, ai besonte se “ishte një incident tragjik por pa ndonjë paramendim.” Ai pretendon se kishte përgatitur dicka me shkrim për intervistën e tij me të pandehurin, por se ajo nuk ekzistonte më sepse ishte humbur ose djegur, dhe se ishte një “dokument jo i vërtetë, ishte thjesht një copë letër.”

38. Sh ■ i tregoi gjithashtu policisë se në kohën e incidentit, njësia “P ■” vërtet kishte libër të regjistrimit të municioneve dhe të pushkëve, por se ai libër nuk dokumentonte se sa plumba kishte marrë një ushtar para se të fillonte ndërresën e tij dhe sa kishte kthyer pas përfundimit të ndërresës së tij. Sipas Sh ■, nuk ishte e nevojshme të numëroheshin plumbat.

¹ Ky dëshmitar shpjegoi se B ■ dhe Gashi janë mbiemrat më të përhapur në atë zonë, dhe se prandaj një person mund të përdorë njësoj emrin “G ■ B ■” kur në fakt është duke folur për “Gani Gashin”.

² Imam – udhëheqës fetar

Deklarata e M [REDACTED] V [REDACTED] dhënë Policisë së UNMIK-ut më 31 Tetor 2007

39. M [REDACTED] V [REDACTED] e përshkroi veten si “mbikëqyrës” të pikës së UÇK-së në fshatin Komoran më 12 Korrik 1998. Ai i tha policisë se në natën në fjalë, rreth orës 21:30 deri në orën 22:00, ai kishte dëgjuar një të shtënë dhe ishte nisur në drejtim të zhurmës. Ai pretendon se ka parë, nga një largësi prej 20 metrash, derën e hapur të kerrit të O [REDACTED], dhe A [REDACTED] O [REDACTED] të dalë jashtë me një revole që ai filloi ta shkreppte në drejtim të “ushtarëve tanë”. V [REDACTED] i tha policisë se i pandehuri i kishte thënë atij se ai kishte shtënë sepse automjeti i O [REDACTED] nuk ishte ndalur.

Zhvarrimi

40. Në bazë të Urdhrit për Zhvarrim, Këqyrje dhe Autopsi dhe Ekspertizë pas Vdekjes, datë 29 Qershor 2007, dhe një Urdhri të Ndryshuar të datës 22 Gusht 2007, më 30 Gusht 2007 Zyra e Personave të Humbur dhe Forensikës (OMPF) e Departamenti të Drejtësisë (DOJ), UNMIK, bashkë me Njësinë e Krimeve të Luftës të Policisë së UNMIK-ut, kreu zhvarrimin e mbetjeve trupore të I [REDACTED] O [REDACTED]

Ekzaminimi pas Vdekjes i Mbetjeve Trupore të I [REDACTED] O [REDACTED]

41. OMPF kreu ekzaminimin dhe autopsinë e mbetjeve trupore të I [REDACTED] O [REDACTED] më 31 Gusht 2007. Patolog i forensikës ishte S [REDACTED] C [REDACTED], MD (Mjekësia Forensike), MBBS, DLM, DMJ Clin et Path (Londër), kurse antropolog i forensikës ishte A [REDACTED] R [REDACTED]. Në raportin e autopsisë të datës 19 Shtator 2007, Dr. C [REDACTED] identifikoi dhe përshkroi këto lëndime:

- A. frakturë të të dyja eshtrave bazë dhe të dyja eshtrave të hundës
- B. frakturë e vertebrës së parë thoratike
- C. frakturë e vertebrës së dytë thoratike
- D. frakturë e brinjës së parë të majtë të fundit spinal
- E. humbje e fundeve spinale dhe sternale të brinjës së dytë të majtë

42. Raporti i autopsisë deklaronte se “trauma shkaktuar skeletit ishte evidente. Kishte dëmtime të eshtrave të kraniumit, mandiblit, dy vertebrave të para të toraksit dhe brinjës së parë dhe të dytë në anën e majtë.” Për shkak të mungesës së indeve të buta dhe reagimeve jetësore dhe për shkak të ose dëshmi të procesit të shërimit, ekspertët forensikë nuk ishin në gjendje të përcaktonin “me saktësi shkencore” nëse frakturat e eshtrave ishin shkaktuar para apo pas vdekjes.

43. Dr. C [REDACTED] konkludoi se i ndjeri kishte marrë së paku një të shtënë me armë zjarri të drejtuar në zonën e gjoksit të sipërm dhe se gjithë dëmtimi dhe frakturat në pjesën skeletore që u gjetën në lidhje me numrat e lëndimeve 2, 3, 4 dhe 5, përputheshin me lëndimet afër kohës së vdekjes (lëndimet e shkaktuara rreth ose në kohën e vdekjes). Ai deklaroi në raportin e tij se lëndimi në gjoksin e të ndjerit ishte “shkaktuar mendohet gjatë jetës dhe do ta kishte vrarë atë brenda një kohe të shkurtër.” Dr. C [REDACTED] përcaktoi se shkaku i vdekjes së I [REDACTED] O [REDACTED] ishin lëndimet në gjoksin e tij, të shkaktuara nga arma e zjarrit.

Verifikimi mjekësor i lëndimeve shkaktuar Sh [REDACTED] O [REDACTED] dhe S [REDACTED] O [REDACTED]

44. Regjistri i spitalit të Prishtinës pasqyron që Sh [REDACTED] O [REDACTED] ishte pranuar në spital më 15 Korrik 1998 me këtë diagnozë:

Fractura cranii reg. Fronto-parietalis sin (frakturë në anën e majtë të ballit të kafkës);

Corpus alientum metallicum epiduralis reg frontalis sin (objekti i huaj metalik në zonën ndërmjet kafkës dhe trurit në anën e majtë të ballit)

Shënimet e Spitalit të Prishtinës poashtu tregojnë se Sh [REDACTED] ka pasur një operacion të *Croniotomia osteoplasticareg frontalis sin. Extirpatio corpus alienti* (Heqja e një pjese të kafkës, largimi i objektit të huaj, vendosja prapa e pjesës së kafkës), dhe është lëshuar nga klinika më 20 korrik 1998.

45. A [REDACTED] O [REDACTED] i kishte raportuar policisë së vëllau i tij S [REDACTED] O [REDACTED] ishtë lënduar me datë 12 korrik 1998 nga një plumb që e kishte goditur në supin e djathtë. Hetuesit e policisë kanë siguruar raportin mjekësor nga një mjek në Treviso, Itali i cili kishte larguar plumbin nga shpatulla e S [REDACTED] më 12 gusht 2000. Raporti mjekësor thekson se diagnoza klinike që i ishte dhënë S [REDACTED] pas pranimit ishte “Granuloma e një trupi të huaj në regjionin e shpatullës së djathtë”. Raporti i operacionit thekson se procedura e trajtimit për heqjen e plumbit përfshinte: prerjen në formë të rombit dhe eksportimi i indit nën-lëkuror përfshirë granulomën nga objekti i huaj (metalik) në regjionin e shpatullës së djathtë.”

Identifikimi me ADN

46. Gjatë hetimeve asnjë individ ose hetues nuk ka shprehur dyshime që mbetjet mortore të zhvarrosura dhe të bërë autopsi në fakt janë të I [REDACTED] O [REDACTED]. Sidoqoftë, me qëllim të sigurimit të një hetimi të plotë dhe për të eliminuar çdo pasiguri të mundshme lidhur me identifikimin e viktimës, prokurori publik ndërkombëtar ka kërkuar që të kryhet një analizë e ADN-së në një mostër të kocksër së marrë gjatë autopsisë. Rezultatet e ADN-së do të sigurohen gjykatës dhe të akuzuarit në momentin e parë sapo të jenë të gatshme.

Kontrolli i shtëpisë së të akuzuarit

47. Më 16 gusht 2007, policia ka arrestuar të akuzuarin dhe në përputhje me një urdhër të lëshuar nga gjyqtari i procedurës paraprake, ka kontrolluar vendbanimin e tij. Gjatë kontrollit, policia ka gjetur dhe konfiskuar një revole (e tipit “VIS”, me origjinë polake, 9mm kailibër, gjysmë-automatike) me 5 rrathë që janë në karikator dhe që duket të jenë të pashfrytëzuar. Në tytën e armës nuk kishte plumb. Poashtu, policia ka gjetur një uniformë të re kamuflazhi dhe një fotografi. Fotografia tregonte të akuzuarin të veshur me uniformën e kamufluar duke mbajtur një armë zjarri, i rrethuar nga individë tjera poashtu të veshur me unifmorma kamuflazhi e duke mbajtur armë.

48. I akuzuari, gjatë ekzaminimit nga ana e policisë dhe gjyqtarit të procedurës paraprake ka theksuar se revolja ishte në dhomën e djalit të tij dhe se i takonte të birit. Policia e UNMIK-ut dhe prokurori publik ndërkombëtar ia kanë referuar rastin

kallëzimit penal lidhur me gjetjen e revoles “VIS” që është gjetur në shtëpinë e familjes Gashi Stacionit Policor në Fushë Kosovë dhe Prokurorit Publik të Qarkut në Prishtinë për hetime shtesë lidhur me akuzën për *Posedim, kontroll, dhe përdorim të armëve, sipas nenit 328 të KPPK.*

Provat fizike

Karriga e parme e makinës së viktimës

49. Më 30 gusht 2007 hetuesit e WCU kanë kontaktur Z. M. Q. i cili kishte blerë makinën e viktimës, një Fiat Croma, diku në vitin 1998 ose 1999. Në bazë të Z. Q. Croma ka mbetur e parkuar në oborrin e tij në fshatin Kishnarekë për një kohë të gjatë. Z. Q. i tha hetuesve të policisë se kur ai kishte blerë makinën nga O., ajo ishte në gjendje të mirë dhe e pastër, dhe se nuk shiheshin njolla gjaku në të. Në bazë të Z. Q. ai kishte përdorur Cromën për 4-6 muaj deri sa ishte bllokuar motorri dhe që nga atëherë ai kishte lënë makinën të parkuar në oborrin e tij. Ai theksoi se para 3-4 muajsh ai kishte shitur pjesë të Cromës një personi të quajtur S. Sh. i cili merret me metal.

50. Më 30 gusht 2007, Z. Q. ende kishte në posedim të kapakut (të përparëm) kulmit dhe 2 ulëseve të parme të Cromës. Hetuesit e policisë inspektuan këto gjëra dhe gjetën se nuk kishte vrima as në kulm e as në kapakun e makinës, mirëpo kishte një vrimë përafërsisht 10 mm në diametër në pjesën e pasme të ulëses së pasagjerit. Ata vërejtën një lloj të njejtë vrimë në pjesën e parme të të njejtës ulëse. Një hetues forenzik vërtetoi se vrimat në pjesën e parme dhe të pasme të ulëses kishin lidhje, duke treguar që ishin shpuar nga i njejtë objekt. Me pajtimin e Z. Q., ulësja e karrigës u mor si provë.

51. Vrima në ulësen e pasagjerit përputhet me pozitën e lëndimit në mbetjet skeletore të viktimës I. G. të vërtetuara gjatë ekzaminimit post-mortem.

Rrobat e viktimës

52. Më 11 prill 2007, A. O. i ka dorëzuar policëve të UNMIK-ut H. W. dhe W. B. rrobat, përfshirë këmishën, jelekun dhe xhakëtën, të cilat i kishte veshur I. O. në momentin e vdekjes. Këmisha, jeleku dhe xhaketa e I. O. kishin nga një vrimë në pjesën e sipërme gjoksore në shpinë.

PROPOZIMI PËR GJYKIM

(në përputhje me nenin 305, par 1, nën-par 6 të KPKPK)

53. Prokurori publik propozon që gjykimi kryesor në këtë çështje të caktohet dhe të mbahet në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.

REKOMANDIME LIDHUR ME PROVAT DHE DËSHMITARËT

(në përputhje me nenin 305, par 1, nën-par 7 të KPKPK)

54. Prokurori publik ndërkombëtar kërkon që gjykimi të mbahet para Gjykatës së Qarkut në Prishtinë dhe të ftohen këta persona;

Prokuroja publike ndërkombëtare e Qarkut D. W.

I akuzuari Gani Gashi
Avokati mbrojtës i Gani Gashit, Z. Fazli Balaj

55. Prokurorja publike ndërkombëtare e Qarkut rekomandon që këta dëshmitarë të ftohen për të dëshmuar në gjykimin kryesor:

Pala e dëmtuar A [REDACTED] O [REDACTED]

Pala e dëmtuar H [REDACTED] O [REDACTED]

Pala e dëmtuar B [REDACTED] O [REDACTED]

Pala e dëmtuar S [REDACTED] O [REDACTED]

Pala e dëmtuar Sh [REDACTED] O [REDACTED]

Xh [REDACTED] N [REDACTED]

I [REDACTED] B [REDACTED]

M [REDACTED] Q [REDACTED]

H [REDACTED] H [REDACTED]

Dr. I [REDACTED] B [REDACTED]

Dr. T [REDACTED] G [REDACTED]

Dr. S [REDACTED] C [REDACTED], OMPF, UNMIK

A [REDACTED] R [REDACTED], OMPF, UNMIK

Cpt. I [REDACTED] K [REDACTED], Laboratori Forenzik i SHPK-së, Prishtinë

Polici F [REDACTED] D [REDACTED], CO 05730, Policia e UNMIK-ut

Polici H [REDACTED] W [REDACTED], CO 03479, Policia e UNMIK-ut

56. Prokurorja publike ndërkombëtare e Qarkut rekomandon që gjykata ti lexojë dhe ti konsiderojë këto dokumente në gjykimin kryesor:

- Raportin e autopsisë përgatitur nga OMPF, datë 19 shtator 2007, së bashku me mbetjet skeletore, skicat dhe fotot
- Librin e regjistrimeve të Spitalit të Prishtinës, shënimi no. 4110, shënimi për trajtimin e Sh [REDACTED] O [REDACTED]
- Raportin e operacionit datë 12 gusht 2000 për S [REDACTED] O [REDACTED] përgatitur nga Dr. G.B [REDACTED], Unita Operative Generale, Treviso, Itali

57. Prokurori Publik Ndërkombëtar rekomandon që gjykata të rishikojë dhe konsiderojë provat materiale në vijim:

Ulësen e veturës me vrimën hyrëse dhe dalëse, e marrur nga oborri i M [REDACTED] Q [REDACTED], dhe fotografitë e ulëses së veturës

Veshmbathja veshur nga viktimi në kohën e vdekjes, dhe fotografitë e atyre veshjeve/rrobave

Fotografitë nga ajri të vendit të ngjarjes

Fotografitë e të pandehurit në uniformë ushtarake

PROPOZIM PËR VAZHDIMIN E PARABURGIMIT (sipas KPPPK-së Neni 305, paragrafi 2)

58. Prokurori Publik i Qarkut propozon që Paneli i Gjyqtarëve të vazhdojë paraburgimin kundër të pandehurit, për arsye se dyshimet e bazuara për paraburgim vazhdojnë të ekzistojnë, dhe asnjë masë tjetër alternative nuk është e mjaftueshme për të siguruar prezencën e të pandehurit dhe zhvillim të suksesshëm të procedurës penale. Baza për vazhdimin e paraburgimit është si vijon:

Ekziston dyshimi i bazuar që Gani Gashi ka kryer veprat penale, ashtu si janë të përshkruara në aktakuzë (KPPPK Neni 281, paragrafi 1, nën-paragrafi 1)

59. Prokurori Publik i Qarkut tërheq vëmendjen e Gjykatës lidhur me faktet e përmendura në paragrafin 4-51 më lart, *Shpjegimi i arsyeve për paraqitjen e aktakuzës*, si mbështetje për atë se ka arsye të bazuara.

Ka arsye të besohet që Gani Gashi do të pengojë progresin apo zhvillimin e procedurave penale duke ndikuar në dëshmitarë apo bashkëfajtorët (KPPPK Neni 281, paragrafi 1, nën-parag. 2, pika “ii”)

60. Palët e dëmtuara kanë pritur më shumë se tetë vite para se të vijnë dhe të raportojë këtë krim në polici dhe kjo është një indikacion se ata janë friguar nga i pandehuri sepse vëllau i tij ishte një general në UÇK, dhe ta besojnë që i pandehuri apo bashkëfajtorët e tij do të mund të tentonin që të hakmirreshin atyre për atë se ata kanë kërkuar nga autoritetet që të hetojnë dhe ndjekin penalisht rastin.

61. Ka një numër të raportimeve specifike të incidentëve lidhur me të pandehurin, apo njerzëve që kanë vepruar në emër të tij, duke tentuar që t’I mbushin mendjen dëshmitarëve që të mos dëshmojnë apomos të flasin me policinë. H [REDACTED] O [REDACTED] I ka deklaruar policit të UNMIK-ut H [REDACTED] E [REDACTED] më 10 Prill 2007 që para tri viteve H [REDACTED] H [REDACTED] I ka thënë që atij iu janë afruar R [REDACTED] G [REDACTED], Xh [REDACTED] G [REDACTED], dhe Gani Gashi dhe që ata tre I kanë thënë atij (H [REDACTED] H [REDACTED]) që ti thotë familjes O [REDACTED] që ta do ta kallnin shtëpinë e O [REDACTED], po qëse O [REDACTED] do ta raportonte vrasjen e I [REDACTED] G [REDACTED] tek policia. Oficeri Eërthmann e dokumenton këtë deklaratë të H [REDACTED] O [REDACTED] në raportin e tij më datë 10 Prill 2007.

62. Më 22 Gusht 2007 dëshmitari Xh. N. ka deklaruar në polici që atij iu kanë afruar i pandehuri dhe M. V. më 12 Korrik 1998, një orë pas kryerjes së krimit. Sipas N., M. V. I kanë dhënë atij që ai (N.) duhej të ipte një deklaratë ku thuhej që “vetura e viktimës nuk u ndal. N. I’u ka përgjigjur V. që vetura është ndalur, por V. I kanë thënë përsëri që “ ne duhet të themi që vetura nuk është ndalur.”

63. N. më tutje ka thënë në polici që ai është intervistuar lidhur me vrasjen e I. O. nga F. Sh., një Komandant I UÇK-së, dy ditë pas ngjarjes, dhe që të dy kanë dhënë deklaratat me gojë dhe me shkrim lidhur me ngjarjen e ndodhur. N. i kanë dhënë policisë së UNMIK-ut që pasi që ai ka dhënë deklaratën e tij për F. Sh., ai ka pasur edhe një bisedë tjetër me M. V. dhe që V. ka pyetur atë që çfarë lloj informata ai i ka dhënë autoriteteve të UÇK-së. Kur N. I ka përgjigjur që ai i ka thënë të vërteten, V. I ka thënë, “ nuk duhej ta bëje atë.”

64. N. poashtu i ka raportuar policisë së UNMIK më 18 gusht 2007 një person me emrin A. G. ka ardhur me shtëpinë e tij. Në atë kohe ai ishte në shtëpi me vëllau e tij. Sipas N.-A. G. ka kërkuar nga vëllau I N. që të shkojë, dhe pasi që ai u largua A. G. pyeti N. t’I tregojë atij lidhur me rastin. N. pastaj filloi që të përshkruajë se cka ka pari ai më 12 Korrik 1998, por kur erdhi tek pika lidhur me veturën e ndalur të familjes O. A. G. i tha atij që të ndryshojë tregimin dhe t’i thotë policisë që vetura nuk u ndal, dhe nëse një ushtar i UÇK-së do njollosej, do të njollostë/ndot tërë UÇK. N. iu përgjigj që gjithmonë do të thotë të vërtetën. A. G. pastaj i kërkoj nga ai të mos i thotë askujt që ai ishte tek shtëpia e tij, dhe u largua.

Serioziteti i veprës penale, mënyra apo rrethanat në të cilën ishte kryer dhe karakteristikat eprsonale, sjellja e mëhershme, kushtet dhe ambienti në të cilat i pandehuri jeton apo rrethanat personale indikojnë një rrezik që i pandehuri do të kryejë një veper penale të cilën është kërcnuar ta kryjë (KPPPK Neni 281, parag. 1, nën-parag. 2, pika (iii)

65. Siq është sqaruar në paragrafin 58 e me tutje, i pandehuri tashmë veq është kërcnuar për kryejren e veprës penale të Shkaktimit të Rrezikut të Përgjithshëm, KPPK, Neni 291, që do të djeg shtëpinë e familjes O., nëse O. do të raportonte vrasjen e Idriz O. në polici. I pandehuri përkrahet nga një numër I personave, si A. G., i cili ka shprehur dëshiren që të veprojë në emer te tij, që të tentojë te marer dëshmitare që do të bejne deklarime falso lidhur me incidentin penal, apo me anë të personave si M. V., I cili ka bërë kërcënime ndaj dëshmitarëve që do ta thonë të vërteten. Këto karakteristika personale të pandehurit, së bashku me rrjetin e tij të përkrahësve, të cilat janë të gatshëm t’I ndihmojnë të bëjnë apo bartin kërcënime kundër personave të cilat flasin te vërteten, indikojnë që I pandehuri, nëse lirohet mund dhe do të ketë mundësinë dhe mbështetjen që të kryejtë kërcënimin e tij apo edhe për të lënduar apo shkaktojë dëm tek palët e dëmtuara apo dëshmitarët që dëshmojnë të vërteten.

Masat tjera sipas KPPPK Neni 268, paragrafi 1, janë të pamjaftueshme për të siguruar prezencën e te pandehurit, që të prevenojë përsëritjen e veprës penale, dhe te sigurojë një zhvillim të sigurtë të procedurave penale.

66. Raportimi incidentit të kaluar i pandehurit dhe bashkëpunëtorëve të tij duke pyetur njerez për të gënjyer se cka kanë parë kur ka ndodhur krimi, dhe kerçnimet e personave të cilët i kanë raportuar faktet e besueshme, demonstroi që premtimet e të pandehurit që do të qendrojë në Kosovë, ndalimi që t'iu ofrohet njerzve të caktuar, paraqitja në stacionin policor, dorëzania, dhe arresti shtëpiak do të ishin inadekuete/të pamjaftueshme qe te parandalojne ate tw mos ngatrronet me deshmitare apo deshmi dhe marrëveshje të fshehta me bashkëfajtorët.

Me respekt,

(nënshkruar & vulosur)

Deborah Wilkinson
Prokuror Ndërkombëtar Publik i Qarkut